



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Gjakovës

PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS

2025-27

2024

Përmbajtja

Lista e shkurtesave

Hyrje

Konteksti.....

Qëllimi i planit të veprimit.....

Objektivat

Shtojca.....

Shkurtesat

=====

MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KN	Këshilli i nxënësve
KP	Këshilli i prindërve
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve

HYRJE

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente, shtetet orientojnë politikatat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ: **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, etj, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë,

shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes e barabartë në arsim, zbatimin e ligjeve në fuqi.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithë përfshirjen në arsim, si dhe dokumentet tjera strategjike nder sektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës, për të siguruar që të gjithë fëmijët, të jenë përfitues të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të plotë.

Konteksti

Numri i shkollave fillore, të mesme të ultë dhe të mesme të larta në Komunën e Gjakovës është: **46,**

Numri i nxënësve në total është: **13883,**

Numri i nxënësve braktisës në të gjitha shkollat e komunës për vitin shkollor 2022/23 është: **42,**

Numri i nxënësve që janë vetëm me një prind ose pa prindër është: **149,**

Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara për të gjitha nivelet është :**95**

- Dg.Autizëm: 24
- Dg.Sy.Daën: 11

Numri i nxënësve me vështirësi në të nxënë për të gjitha nivelet: **308**

Sa nxënës kanë mungesa shumë për të gjitha nivelet: **518**

Sa nxënës janë në rrezik të braktisjes: **56** Faktorët: **për shkak moshës, braktisje e shkollimit me vetëdëshirë, martesë para kohe, ndërrimi i vendbanimit, për shkak punësimit dhe të penguar nga prindërit**

Komuna e Gjakovës ka ekipin për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në koordinim me shkollat menaxhojnë rastet apo nxënësit në rrezik për braktisje, ata që nuk janë regjistruar apo kanë braktisur.

EPRBM-të shkollorë janë funksionale dhe shumë bashkëpunuese.

Thjesht trajtohen këto elemente e të tjera që vlen të shënohen dhe pretendohen të trajtohen me këtë plan veprimi.

Qëllimi i planit të punës

Koordinimi i veprimeve ndërinstytucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

Objektivat specifike:

- 1.1 Funkcionalizimi i EPRBMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
- 1.2 Koordinimi ndërinstytucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3 Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla fillore te shkolla e mesme e ulët dhe më pas në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

Objektivat specifike:

- 2.1. Koordinimi në mes të shkollës (të shtohet dhe shkolla fillore pasi që nga aty fillon rreziku për braktisje) së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të (duke filluar nga klasa e parë)
- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;
- 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës
- 2.4. Vetëdijësimi i prindërve rreth rëndësisë së arsimit fillor drejt rrezikut për braktisje të shkollës, përmes takimeve me prindër.
- 2.5. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

Rezultatet kryesore të pretenduara:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Funksionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa

- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/ zvogëlimi i braktisjes
- Forcimi i bashkëpunimit me akterët gjegjësisht në nivel komune lidhur parandalimin e braktisjes

Buxheti:

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 38080 € . Ky buxhet duhet të mbështetet nga DKA-ja, por në rast të mungesës së fondeve duhet të realizohet në formë vullnetare. Siç është realizuar vullnetarisht deri me tani.

Monitorimi:

Zbatimin e këtij plani e monitori EPRBM komunale, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërohet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashtëmujore dhe vjetor

Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBMve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim								
Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune								
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
1.1.1	Funksionalizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi, procesverbalet, agjendat	X			DKA	Komuna MASHTI	Kosto administrative
1.1.2.	Themelimi i EPRBM në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar	Vendimet e EPRBM-ve shkollore	X			DKA	MASHTI Partnerët	Kosto administrative
1.1.3	Takime informuese dhe koordinuese, EPRBM komunale me EPRBM-të shkollore	Agjendat, listat e pjesëmarrjes dhe procesverbalet, rekomandimet. (4 Takime në vit, dhe takime të tjera sipas nevojës)	x	x	x	EPRBM komunale	DKA	2000€

		32 shkolla pjesëparrëse						
1.1.4	Seanca mbështetëse për EPRBM-të shkollore	Agjendat, listat e pjesëmarrjes	X	x		DKA	MASHTI Partnerët	Donatorët 4000€
1.1.5.	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorimine SPH-së	Dy takime	X	x	X	DKA	MASHTI Partnerët	750€
1.1.6.	Mbështetja e EPRBM-së komunale rreth financimit të aktiviteteve me shkollat(veshëmbathje, ushqim, mjete mësimore,transporti i ekipit).	Nr i nxënësve të mbështetur			X	Dka Të planifikohet në buxhetin vjetor të DKA-së		900€ + 100€ transporti i ekipit
Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitutional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			

1.2.1	Takime koordinues me partnerë	Tri takime brenda vitit, rezultatet	x	x	x	DKA,shkollat,	MASHTI Partnerët QPS QKMF ZKK PK	500€
1.2.2	Zhvillimi i projekteve ndërgjegjëse, vetëdijëse, nxitëse në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt të shkollës të gupeve të caktuara të nxënësve	Nr. i projekteve, aktiviteteve ndërgjegjëse Vitin e parë 23 shkolla 150 nxënës Vitin e dytë 23 shkolla 150 nxënës	X Prill Maj	X	x	DKA,shkollat	Drejtoritë tjera komunale Partnerët	Buxhet nga donatorët
1.2.3	Mbështetja e nxënësve të shkollave të mësimi të larta me bursa dhe stimuj të tjerë (shpërblime) për	20 bursa brenda vitit 2025 – për 3 muaj = 100 euro për nxënës			X	DKA	Partnerët	Buxhet i Drejtorisë Komunale të Arsimit 2000€ në vit

	motivimin e shkollimit të qëndrueshëm.	20 nxënës						
1.2.3.	Mbeshtetje e nxënësve me psikolog ose ndihma te tjera varsish nga nevoja e nxënësve nga vizitat ne terren e EPBRM-se	Nr, nxenseve				DKA,shkolla, QPS	Partneret	
1.2.4	Mbeshtetje e nxënësve me psikolog ose ndihma te tjera varsish nga nevoja e nxënësve nga vizitat ne terren e EPBRM-se	Nr i nxenseve caktohet nga shkolla	X	X	X	DKA,shkolla, QPS	Partneret	Janë psikologt në disa shkolla brenda komunës
Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
1.3.1.	Zhvillimi i një sistemi të regjistrimit kumulativ për nxënësit e klasave 1-9	Regjistri i zhvilluar në mungesë t ditarit digjital të krijohen dosjet	x	x	x	MASHTI	Partnerët	MASHTI shkollat.org

		digjitale të fmijeve në platformen shkollat.org Evidencat				DKA shkollat		
1.3.2.	Sigurimi i trajnimeve për mësuesit dhe administratorët e shkollave se si të mirëmbajnë dhe përdorin sistemin e regjistrimit kumulativ;	Trajnimet e zhvilluara		x	x	DKA MASHTI	Partnerët	MASHTI
1.3.3	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe joakademik të nxënësve	Tri takime brenda vitit	x	x	x	Shkollat	DKA	
1.3.4	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vështirësi akademike ose personale;	Buxheti i ndarë Aktivitetet e realizuara	x	x	x	DKA shkollat	MASHTI MEF	
1.3.5.	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve	SPH funksional dhe i përdorshëm	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	

	të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe çështjet e sjelljes.	nga të gjitha shkollat						
1.3.6	Identifikimi i nxenseve të cilët kanë mbetur pa u regjistruar fare dhe gjetja e nje zgjidhje per ata femije	Aktivitete koordinues me gjendjen civile,me partnerët	X	X	X	Ojq-të, Qendrat mësimore, EPRBM-të.	Shkollat DKA	Pa kosto
1.3.7								
Objektiva e përgjithshme 2. Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.								
Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës fillore, shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 1-rë								
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e	U.A i zbatueshëm	x	x	x	Shkollat	MASHTI Partnerët	

	hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	Aktivitet e rregullta, të realizuara Në bashkëpunim me këshilltarët e karrierës				Këshilltari i karrierës DKA		
2.1.2.	Organizimi i panairove të karrierës për t'i ekspozuar nxënësve para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimi.	Së paku dy panairove brenda vitit	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	2000€ në bashkëpunim me shkollat
2.1.3	Angazhimi i këshilltarëve për orientimin në karrierë në shkollat e mesme të ulëta për t'u ofruar nxënësve këshilla dhe mbështetje profesionale.	Në çdo shkollë këshilltari i karrierës tu ofroj nxënësve nga klasa VI deri IX këshilla grupore dhe individuale për orientim në karrierë Nr. i këshilltarëve të karrierës të		x	x	DKA	MASHTI	MASHT DKA

		punësuar në shkolla (në proces të zbatimit të UA në fuqi, në mungesë të këshilltarit të karrierës këtë ta bëjë (psikologu dhe pedagogu) i shkollës						
2.1.4	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen, i cili përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.	SHML çdo vit të punës, të bëjnë promovimin e drejtimeve që ofron secila shkollë, përfitimet dhe arritjet për secilin drejtim. Ku mund të sjellin nxënës në cilësinë e folësit motivues që të prezantoj para nxënësve të arriturat dhe rezultatet e tij/saj.		x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	

		1 Herë në vit						
2.1.5.	Përfshirja e nxënësve në aktivitete të ndryshme, në gara, mësim plotësues, punëtori brenda shkollës, me fokus nxënësit në rrezik braktisjes	Plani i aktiviteteve të hartuar nga EPBRM shkollore	X	X	X	EPRBM Shkollore, Shkolla	EPRBM Komunale	
2.1.6.	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasës 9 në SHML	Vizitë në SHML, çdo vit të punës, vizita të organizohet me të gjithë nxënësit e klasëve të nënta, në mënyrë që ata të eksplorojnë më tepër drejtimet e ndryshme dhe të njihen nga afër me mundësitë që i ofron shkolla, që çdo nxënës të zhvillohet në	x	x	x	DKA-Shkolla	OJQ,Bizneset	3500

		kapacitetet dhe aftësitë e tij. Orari i vizitave dhe koordinimi në mes të nivelit të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë. 1 herë në vit Raportet dhe fotot e vizitave						
Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
2.2.1	Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.	Çdo SHML, njëherë në vit të përgadit broshura me informacione për të gjitha profilet që ofrojnë dhe ato	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	3750

		ti shpërndaj në të gjitha SHFMU. 1 herë në vit Materialet e përgatitura(Broshura, postera, video mesazhe etj)						
2.2.2	Punëtori me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm	Nr. i punëtorive, takimeve të realizuara	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	4600
2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre.	Nr. i seminareve e realizuara me nxënës	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	
2.2.4.	Takime senzibilizuese me	Secila shkollë duhet të marrë përsipër		x	x	Shkollat	MASHTI	Pa kosto

	prindër, nxënës dhe folës motivues.	organizimin e takimeve sensibilizuese me prindër, nxënës dhe folës motivues të fushave të ndryshme, dhe këtë ta realizoj në periudhën e II-Të të vitit shkollor. 1 Takim për një vit shkollor Numri i takimeve të realizuara me klasën e 6,7,8,9 (mars-prill-maj)				DKA	Partnerët	
2.2.4	Takime bashkëpunimi me Grupin Keshillues ne Komunitet (Është grup joformal që merren me fëmijët që janë në	Së paku dy gjatë vitit shkollor	X	X	X	EPRBM komunale dhe shkollore	DKA QPS	Pa kosto

	rrezikshmëri të mesme dhe të ulët)							
Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
2.3.1.	Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit	Nr. i marrëveshjeve dhe i takimeve me partnerë		x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	4080(buxheti për transport)
2.3.2.	Zbatimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit sipas përgjegjësi të ndara	Nr. i shkollave dhe profileve përfituese të marrëveshjeve Nr. i nxënësve që mbështeten për punën praktike.		x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	(sigurimi i nxënësve për punën praktike)
2.3.3								
Objektiva specifike 2.4. Vetëdëjimi i prindërve rreth rëndësisë së arsimit fillor dhe parandalimit të rrezikut për braktisje të shkollës, përmes takimeve me prindër.								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor					Buxheti

			2025	2026	2027	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	
2.4.1.	Takime me prindër, komunitet	3 takime me grupet e cënueshme në muajt para regjistrimit të fëmijëve në klasë të parë	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Kosto administrative
2.4.2.	Sesione informues për mësimin Joformal me shkolllat-administrata	Numri i fëmijëve të identifikuar që kanë kaluar moshën e regjistrimit	x	x	x	EPRBM Komunale	DKA-ja	Kosoto administrative
2.4.3	Aktivitete sensibilizuese në parandalim të punës së rrezikshme për fëmijës	Materialet, video promovuese, takime ndërinstitucionale me komunitetin e prindërve	x	x	x	DKA QPS Shkollat	Partnerët	Kosto e mbuluar nga partnerë
Objektiva specifike 2.5. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit								

	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2025	2026	2027			
2.5.1.	Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese	Korniza monitorues e zhvilluar Korniza monitorues e zhvilluar (punëtoitë e zhvillimit të kornizës, aktivitetet monitoruese, evidenca e rasteve të trajtuara)	x			DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	9900 (kostoja e dy punëtorive, e aktiviteteve monitoruese, e dajljeve në terren)
2.4.2.	Mbledhja e të dhënave sipas kornizës monitoruese	Të dhënat e mbledhura	x	x	X	DKA Shkollat	Partnerët	Ksoto administrative
2.4.3	Analiza e të dhënave	Të dhënat e analizuara	x	x	X	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Kosto administrative
2.4.4.	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit	Raportimi i rregullt vjetor	x	x	X	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Kosto administrative

Shtojca : Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë

Ligjet

- Kushtetuta e Kosovës,
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji nr. 2003/12 për Qasjen në dokumente zyrtare, 6 nëntor 2003, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2470>
- Ligji nr. 03/L – 172 për Mbrojtjen e të dhënave personale, 31 Maj 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2676>
- Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 1 Mars 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

Udhëzimet administrative

- Udhëzimi administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsiminparauniversitar <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-adinistrativ-masht-nr-08-2018-per-themelimin>

[dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu/](#)

- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 dhjetor 2012, <https://masht.rks-gov.net/9-ua-per-mbledhjen-dhe-raportimin-e-te-dhenave-statestikore-nga-shkollat-dhe-institucionet-parashkollore-ne-arsimimin-parauniversitar-duke-perdorur-sistemin-per-menaxhimin-e-informative-ne/>
- U.A për transferin e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/16-ua-per-kalimin-e-nxenesit-te-shkolles-se-mesme-te-larte-prej-nje-profil-arsimor-ne-tjetrin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeter-nr-16-2011-date-30-12-2011/>
- UA. 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht-nr-08-per-dokumentacionin-shkollor-ne-arsimin-parauniversitar/>
- U.A 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-njohja-e-dokumente-te-arsimit-parauniversitar-te-leshuara-jashte-republikes-se-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- U.A. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sistemin-e-nxenesve-te-cilet-kane-migruar-nga-viti-shkollor-2014-2015/>
- U.A. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit e riatdhesuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-dt-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kriterëve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mesimit-plotesues-per-nxenesit-e-riatdhesuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- U.A 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-aftesimin-profesional/>.
- U.A 02/2014 Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP, resurset, infrastrukturadhe siguria e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-02-2014-numri-i-nxenesve-me-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>

- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>
- UA- MASHT Nr: 12/2014 Përjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-12-2014-perjashtimet-ne-moshe-me-rastin-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-aftesimin-per-te-rritur/>

(Politika për mësimin dual ka filluar nga shtatori 2022 fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe murator)

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimin, me synimin që në secilën komunë të bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimi për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërlidhen me punën që e bëjnë nxënësit nën moshën 18 vjet.

Strategjitë kombëtare/planet e veprimit

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023),
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2022-2026).

Të tjera

- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)*
- *Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Trajtimi i refuzimit të shkollës dhe braktisjeve Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)*

- : doracak i orientuar kah praktika [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual] (tetor 2011).
- Raporti i OSBE-së: Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë <http://ëëë.osce.org/sq/kosovo/95113?download=true> (qasur më 24 mars 2014).
- Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë (MASHT & UNICEF 2004).
- Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë (MASHT, 2008)
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, Femijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2014)
- UNICEF, Përmbledhje e Politikave - Të gjithë femijët regjistrohen, vijnë dhe përfundojnë arsimimin, 2014